POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 
Atentati ndaj Sadikajt/ Zbulohet e shkuara kriminale e nënës së tij, shfrytëzonte lokalin për prostitucion! E ndihmonin 2 policë

2 
I rrethuar nga familjarët dhe duke qarë, momenti prekës kur babai i vogëlushes 5 vjeçare shkon tek vendi ku ajo u gjet e vrarë

3 
Pas vizitës në Kiev Macron i kërkon prodhuesit francez të armëve të rrisë prodhimin

4 
'Clan del Golfo'-s iu sekuestrua 4.3 ton kokainë, disa prej të prangosurve fillojnë 'të pendohen'! Mes të arrestuarve edhe djemtë e ish-kryekomunarit të PD (Emrat)

5 
Ekskluzive në 'Pa Gjurmë'! 'Zbërthehet' pas 20 vitesh zonja që bashkëpunoi me trafikantët: Mbajta të miturën kundrejt parave, nënën ia trafikuan fierakët

Kronikë

# Atentati në Shkodër/ Viktima jepte para me fajde! Autori me 2 armë në brez, s'iu shkrep pistoleta, e qëlloi me 'scorpions'

*Detaje të reja mësohen nga krimi në Shkodër, ku mbeti i vrarë Lulash Qepuri. Autori ende i paidentifikuar është kapur nga kamerat e sigurisë me maskë dhe dy armë. Krimi ndodhi në prezencë të të birit, i cili ka qëlluar me armë ndaj atentatorit.*




[Sh] .com Redaksia
16 Qershor, 12:19 | **Përditesimi i fundit: 16 Qershor, 16:26**

**SHKODËR**- Detaje të reja kanë dalë nga ekzekutimi i 74 vjeçari ***Lulash Qepurit*** mbrëmjen e djeshme në Shkodër, brenda lokalit të tij në fshatin Stom Golem. Ende nuk është identifikuar autori, por burime nga grupi hetimor thanë se viktima jepte para me fajde. Ndërsa 10 vite më parë Lulash Qepuri ka qenë i arrestuar pasi në banesë u gjetën armë dhe kanabis.

Ngjarja ndodhi rreth orës 21:40 të së mërkurës, ku sipas burimeve policore një person i maskuar ka hapur zjarr ndaj 74 vjeçarit fillimisht me një pistoletë e cila i është bllokuar e më pas ka përdorur një armë tip 'scorpions'. I gjendur në lokal, i biri i viktimës ka marrë një shotgun duke iu kundërpërgjigjur me zjarr autorit.

[Sh] .com



LEXO EDHE:
**Breshëri plumbash në Shkodër, vritet në lokalin e tij 74-vjeçari! I biri kundërpërgjigjet me shotgun e më pas telefonon policinë: Më vranë babanë**

Ndonëse ka shtënë disa here në drejtim të tij nuk ka mundur të shënjestrojë atentatorin e të atit. Blutë e Shkodrës dhe grupi hetimor kane arritur të gjejnë 26 gëzhoja në vendngjarje nga tre armë të ndryshme ndërsa kanë sekuestruar dhe pamjet nga një kamera sigurie ku shihet silueta e autorit të maskuar, por deri me tani nuk kanë arritur ta identifikojnë.

Mësohet se pasi ka njoftuar sallën operative të policisë edhe djali i viktimës është arratisur nga vendi i ngjarjes, por më pas është shoqëruar në Polici.

Qepuri rezulton i arrestuar në vitin 2011, pasi gjatë kontrollit në shtëpinë dhe lokalin e tij në atë kohë i është gjetur drogë dhe kallashnikov. Konkretisht policia i ka sekuestruar në atë kohë 1 armë zjarri Automatik mod.56, 1 armë zjarri tip Revolver shtatëshe, 262 copë fishekë të modeleve të ndryshme, fitila zjarr përcjellës, 111 copë kapsolla detonatorë, si dhe një qese prej 55 gram me fara të bimëve narkotike kanabis sativa.

B.K./Sh.Sh/Shqiptarja.com

TAG: te shtena me arme | Lulash Qepuri | Shkoder

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

**Sondazhi i ditës:**
**Rritja e çmimeve, a duhet të ketë një tjetër Paketë të Rezistencës Sociale?**

PO | JO | NUK E DI

## Lajme të tjera

Kronikë

**Zhduken dy të mitur në Shkodër, nëna denoncon humbjen e tyre: Janë larguar që në datën 1 qershor! Policia nis kërkimet**
15 Qershor, 13:03

Sociale

**Fermerët në Vaun e Dejës në protestë për naftën pa akcizë, deputeti Hila: Përfitojnë nga 3 mijë litra naftë persona që nuk kanë asnjë pëllëmbë tokë të punueshme**
15 Qershor, 11:04

Kronikë

**Velipojë, qëllohet në plazh me një plumb në bark 48-vjeçari Pjerin Brushtulli, dërgohet në spitalin e Shkodrës! Në vitin 2002 vrau bashkëfshatarin e tij**
14 Qershor, 22:13

Kronikë

**Lëvizte me kallashnikov me vete, 22 vjeçari tenton ti largohet policisë në Malësi të Madhe, arrestohet**
14 Qershor, 16:51

Kultura

**Realizohet dokumentari 'Në Kujtim' në Shkodër në nder të mjeshtrit të madh Kujtim Alija! Nismëtari i rikrijimit të Orkestrës Frymore të qytetit**
Ergys Kavaja
14 Qershor, 16:01

Kronikë

**Droni zbulon 560 bimë narkotike në Velipojë, arrestohet 24-vjeçari, në kërkim shoku i tij**
14 Qershor, 12:31

Kronikë

**Ndërron jetë kryetari i shoqatës se misionarëve të pajtimit të gjaqeve në Shkodër, ndërmjetësoi (pa sukses) për lirimin e Jan Prengës**
14 Qershor, 12:05

Kronikë

**Aksident i rëndë në Shkodër, mjeti përplaset me motoçikletën! Plagoset 26-vjeçari, tjetri largohet nga vendngjarja**
13 Qershor, 22:21

Kultura

**Mbyllet edicioni i 60-të/ Gara mes 20 artistëve të vegjël, rrëmben çmimin e parë kënga 'Festivali na thërret'!**
13 Qershor, 22:08

Sociale

**Celebrimi i 100 vjetorit Shqipëri-SHBA, përshendetja veçantë e Kim në publik: Më duket sikur vij në familjen time, ju mirëpres në Amerikë**
12 Qershor, 14:39

Kronikë

**Belgjikë/ Shqiptari plagos me armë zjarri një person, kush është Kasandro Noga, personazh i njohur i botës së krimit**
11 Qershor, 22:46

Ekonomi

**Lider botëror në robotikë, drejtori i 'Comau': Do investojmë në Shkodër**
Ergys Kavaja
9 Qershor, 20:22

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje